



FORMULAR I KËRKESËS SË RREGULLT PËR KOMPENSIM NGA PROGRAMI I KOMPENSIMIT TË VIKTIMAVE TË KRIMIT

Udhëzim: Kërkesa e rregullt për kompensim parashtrohet pas përfundimit të procedurës së rregullt gjyqësore, respektivisht pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Për të kërkuar kompensim të rregullt, viktimat është e obliguar të kërkojë fillimisht dëmshpërblimin nga i pandehuri në procedurën penale.

Kërkesa mund të paraqitet edhe në rastet kur viktimat dokumenton se e ka të pamundur paraqitjen e një kërkesë të tillë. Për kërkesat që janë pranuar në kuadër të kërkesës për kompensim të menjëhershëm, kompensimi jepet për pjesën tjetër të pa kompensuar dhe për kategoritë tjera për të cilat viktimat nuk është kompensuar.

Të dhënat e përfshira në këtë formular do të konsiderohen si të dhëna konfidenciale dhe mund të përdoren vetëm për qëllim të kompensimit financiar të parashtruesit.

PJESA 1: Të dhënat e parashtruesit të kërkesës (plotësoni këtë pjesë nëse jeni personi që e paraqisni kërkesën në emër të viktimës). Bashkëngjisni dokumentin e identifikimit dhe dokumentin që tregon raportin tuaj me viktimën.

Emri dhe Mbiemri:		Shtetësia:	
Nr. Telefonit:		Email:	
Raporti me viktimën (zgjedh opcionin që tregon lidhjen tuaj me viktimën)	<input type="checkbox"/> Bashkëshort <input type="checkbox"/> Anëtar tjetër i familjes (Specifiko): _____	<input type="checkbox"/> Kujdestar ligjor	

PJESA 2- Të dhënat e viktimës (plotësohet vetëm nëse është ndryshe nga parashtruesi në Pjesën 1). Bashkëngjisni dokumentin e identifikimit.

Emri dhe Mbiemri:		Shtetësia:	
Data e lindjes:		Vendi i lindjes:	
Nr. i telefonit:		Email:	

PJESA 3- Vepra penale për të cilën kërkohet kompensim (bashkëngjisni dokumentet si më poshtë):

Vepra Penale: _____

Aktgjykimi i plotfuqishëm i gjykatës në çështjen penale.

Vendim apo dokument tjetër zyrtar që dëshmon se kompensimi në procedurë penale ka qenë i pamundur për tu realizuar (për më shumë detaje shiko Nenin 9 të Ligjit).

Specifiko llojin e dokumentit: _____

PJESA 4- Lloji i kompensimit që kërkohet:

Në kuadër të kompensimit të rregullt viktimat mund të kompensohen për dëme të caktuara të listuara më poshtë. Zgjedhni kategori/të për të cilin kërkoni kompensim dhe bashkëngjisni dokumentacionin e nevojshëm si raportet mjekësore dhe kuponat fiskal për të mbështetur kërkesën tuaj.

<input type="checkbox"/>	a. Kompensimi për lëndimin fizik apo dëmtimin e shëndetit
<input type="checkbox"/>	b. Kompensimi për shpenzimet e paguara mjekësore, hospitalizimit, barnave apo shërbimeve tjera përcjellëse në rastet e lëndimit të rëndë fizik (<i>bashkëngjisni raportet mjekësore nga specialist dhe kuponat fiskal</i>)
<input type="checkbox"/>	c. Kompensimi për vuajtjen psikike (<i>për viktimat fëmijë, dhunës në familje, trafikimit me njerëz, dhunimit, sulmit seksual, detyrimit për pornografi, viktimat që janë nënshtruar shpërfytyrimit, abuzimeve psikike, seksuale, dhe fizike në mënyrë të vazhdueshme</i>). Nuk ka nevojë të dokumentohen shpenzimet.
<input type="checkbox"/>	d. Shpenzimet e paguara mjekësore, hospitalizimi, barnave apo shërbimeve tjera përcjellëse në rastet e dëmtimit të shëndetit mendor (<i>raportet mjekësore nga specialist psikiatër apo psikolog dhe kuponat fiskal</i>)
<input type="checkbox"/>	e. Kompensimi për vuajtje psikike për humbjen e anëtarit të familjes (<i>anëtarët e familjes duhet të bashkëngjisin raportet për trajtimin e shëndetit mendor nga specialistët psikiatër apo psikolog dhe kuponat fiskal për shpenzimet e paguara mjekësore</i>)
<input type="checkbox"/>	f. Kompensimi për humbjen e së drejtës në mbajtje. Shënim: <ul style="list-style-type: none">- Kur viktimë ka pësuar lëndime të rënda fizike dhe kërkon kompensim për humbjen e së drejtës në mbajtje të vartësve duhet të bashkëngjet dëshmi të punësimit dhe dëshmi që ka qenë mbajtës kryesor i vartësve. Bashkëngjitet edhe certifikata e bashkësisë familjare.- Kur viktimë është e ndjerë, anëtarët e familjes duhet të bashkëngjisin dëshmi se viktimë ka qenë mbajtësi kryesor financiar, dëshmi mbi gjandjen financiare të vartësve dhe certifikatën e bashkësisë familjare.
<input type="checkbox"/>	g. Shpenzimet e paguara për blerjen dhe riparimin e pajisjeve mjekësore (<i>raport mjekësor dhe kuponat fiskal</i>).
<input type="checkbox"/>	h. Shpenzimet e varrimit (<i>nuk ka nevojë të dokumentohen shpenzimet</i>). Bashkëngjiten vetëm Autorizimi nga anëtarët e tjerë të familjes, Çertifikata e bashkësisë familjare apo Aktvdekja.

PJESA 5- Dokumentet (shënoni secilin nga dokumentet që i bashkëngjisni kërkesës)

<input type="checkbox"/>	a. Aktgjykimi i formës së prerë	<input type="checkbox"/>	b. Dokumenti i identifikimit
<input type="checkbox"/>	c. Dëshmia të punësimit të viktimës (<i>kontrata e punës</i>)	<input type="checkbox"/>	d. Raportet mjekësore nga specialistë të fushës
<input type="checkbox"/>	e. Dëshmi të shpenzimeve (<i>kuponat fiskal</i>)	<input type="checkbox"/>	f. Autorizimi i parashtruesit të kërkesës (<i>kur kërkesa parashtrohet nga anëtarët e familjes</i>)
<input type="checkbox"/>	g. Çertifikatën e bashkësisë familjare	<input type="checkbox"/>	h. Çertifikatën e vdekjes / Aktvdekjen
<input type="checkbox"/>	i. Dokumenti që dëshmon se viktimë ka qenë mbajtësi kryesor dhe dëshmia mbi gjendjen financiare të vartësve	<input type="checkbox"/>	j. Vendimin për kujdestarinë ligjore
		<input type="checkbox"/>	k. Të tjera _____

PJESA 6- Kompensimet e realizuara në procedura tjera (deklarohuni nëse keni pranuar kompensim tjetër dhe bashkëngjisni dëshmi për kompensimin e realizuar)

Jo Po Nëse Po, specifíkoni: _____

PJESA 7- DEKLARIME DHE VËREJTJE (ju lutemi lexoni me kujdes). Formulari nuk konsiderohet i plotësuar nëse nuk janë klikuar të gjitha pikat e mëposhtme.

- Konfirmoj se të gjitha të dhënat në dokumentin e sipërm si dhe dokumentet e bashkëngjitura janë të vërteta dhe të sakta** (Vërejtje: Paraqitja e të dhënave të pasakta paraqet bazë për kallëzim penal sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës).
- Konfirmoj se do njoftoj Komisionin për Komensimin e Viktimave të Krimit me kohë në rast të ndryshimit të dhënave të paraqitura.**
- Jap pëlqimin tim që Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit të dhënat e specifikuar në këtë formular dhe në dokumentet mbështetëse ti verifikojë sipas nevojës me institucionet relevante.**
- Konfirmoj se do të rikthej çfarëdo pagesa të bëra gabimisht.**
- Konfirmoj se do të kthej shumën e dhënë nëse në ndërkohë pranoj kompensim nga ndonjë burim i dytë për të njëjtën kategori të kompensimit.**
- Jap pëlqimin tim që në rast të pranimit të kompensimit nga Programi për kompensim, të drejtat e mia si palë e dëmtuar për të kërkuar kompensim nga i pandehuri, ti kalojnë Qeverisë së Kosovës në ditën e ekzekutimit të vendimit për njohjen e të drejtës për kompensim dhe atë deri në lartësinë e kompensimit të pranuar nga shteti.**

PJESA 8- Nënshkrimi i viktimës, respektivisht anëtarit të familjes që parashtron kërkesën:

Emri dhe Mbiemri: _____

Nënshkrimi: _____

Datë: ___/___/_____

SHTOJCË: Të dhënat e përfaqësuesit të autorizuar (avokati, mbrojtësi i viktimave, përfaqësues nga OJQ) kur kërkesa është plotësuar dhe dorëzohet në emër të viktimës apo vartësve. Përfaqësuesi duhet të dorëzojë edhe autorizimin:

Emri dhe Mbiemri: _____ Funkzioni: _____

Tel: _____ Email adresa: _____